

PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Drejtësia në jetën dhe sjelljen e shtetit është e mundur vetëm pasi së pari ajo banon në zemrat dhe shpirtrat e qytetarëve.

STORIE E SUKSESIT

Rritet komunikimi mes qytetarëve dhe gjykatës.

LAJME

GJYKATA NË MEDIA

Ka një gjykatë më të lartë se ajo e drejtësisë, është gjykata e ndërgjegjes. Ajo zëvendëson të gjitha gjykatat tjera.

INTERVISTË E SHKURTË


Luan Berisha (gjyqtar i Departamentit të Përgjithshëm - Divizioni Penal).

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Njoftim!

A e dini se...?!

Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit.



GJYKATË E HAPUR

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
Janar 2019

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 13, janar 2019

Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit

www.gjyqesori-rks.org

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Drejtësia në jetën dhe sjelljen e shtetit është e mundur vetëm pasi së pari ajo banon në zemrat dhe shpirtat e qytetarëve. Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike .

Viti 2018 ishte viti i rezultateve konkrete të punës dhe e hapjes së mëtejme të Gjykatës Themelore të Prizrenit ndaj qytetarëve. Gjatë këtij viti gjykata i tejkaloj të gjitha parashikimet e punës, si në aspektin e trajtimit të lëndëve, po ashtu edhe në promovimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies.

Gjykata themelore e Prizrenit synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës në gjykatë nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.gjyqesori-rks.org, ku publiku ka qasje edhe në publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme ku gjykata ka arritur që gjatë këtij viti ti publikoj gjithsej 1623 aktgjykime të plotfuqishme.

Përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit informativ nr.13 që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës, statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Përveç suksesit, kjo gjykatë ka edhe sfidat me të cilat po ballafaqohet çdo ditë. Njëra ndër sfidat kryesore të gjykatës është mungesa e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional, stafit administrativ, mungesën e përkthyesve, e të cilat paraqesin një sfidë sa i përket punës së kësaj gjykate.

Sfidë tjetër kemi edhe mungesën e hapësirës së gjykatës, ku Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kërkuar nga Komuna e Prizrenit që të siguroj lokacionin për ndërtimin e objektit të ri, por e njëjta ende nuk i ka dhënë zgjidhje kësaj çështje.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur e cila do të vazhdoi të investoi në forcimin e standardeve profesionale dhe transparencës.

Ymer Hoxha

Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren

STORIE E SUKSESIT

Rritet komunikimi mes qytetarëve dhe gjykatës



Gjykata Themelore në Prizren i ka hapur dyert e saj për gjithë qytetarët e interesuar që dëshirojnë të vizitojnë dhe të mësojnë më shumë për gjykatën e tyre. Komunikimi i qytetarëve me shërbyesit e drejtësisë është një parakusht për krijimin e besimit në drejtësinë që ndahet në këtë gjykatë dhe e mban të informuar gjykatën për kërkesat që kanë qytetarët. Gjykata përmes vizitave e rrit edhe më tej komunikimin mes qytetarëve dhe kësaj gjykate.

Kryetari i kësaj gjykate pret dy herë në javë qytetar me të cilët diskutohet për kërkesat, nevojat dhe shqetësimet që kanë të dyja palët në raport me gjykatën dhe drejtësinë.

Gjykatën e Prizrenit e vizituan nxënësit dhe përfaqësuesit e Bibliotekës Ndërkomunale të Prizrenit



Me datën 29.10.2018, në orën 12:00, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan nxënësit së bashku me përfaqësuesit e Bibliotekës Ndërkomunale në lidhje me projektin me titull, ”Zbatimi i ligjit dhe roli i tij në zhvillimin ekonomik”.

Qëllimi i këtij projekti është që ti angazhojnë studentët e drejtimit ekonomik dhe juridik të Shkollës Ekonomike në Prizren, ashtu që këta të rinjë të kuptojnë rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe rëndësinë se si përmes ligjit bëhet edhe zhvillimi ekonomik i vendit. Nga ky projekt të rinjtë përveç njohurive që do të marrin nga persona profesionist, atë në të njëjtën kohë do ta kenë mundësinë që shumë gjëra ti shohin si realizohen edhe në praktik. Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bëjnë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme. Nxënësit u pritën në njërën nga sallat e gjykimit nga Zyrtarja e Lartë për Monitorim me Publikun z. Afërdita Kicaj, e cila prezantoi strukturën e gjykatës, punën që bëjnë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të marrin pjesë në një seancë gjyqësore të hapur për publikun. Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Studentët e vitit të parë të fakultetit juridik “Ukshin Hoti” vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit



Me datën 06.11.2018, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentet e vitit të parë të fakultetit juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” të Prizrenit. Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bënë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme. Studentët u pritën në njërën nga sallat e gjykimit ku u prezantua struktura e gjykatës, punën që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjell reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkt me Kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre, me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës.

Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët, Universitetet me Shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Grupi i dytë i studentëve i vitit të parë të fakultetit juridik “Ukshin Hoti” vizituan Gjykatën e Prizrenit



Me datën 07.11.2018, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentet e vitit të parë të fakultetit juridik të Universitetit “Ukshin Hoti”, në Prizren.

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bëjnë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Studentët u pritën në njërën nga sallat e gjykimit ku u prezantua struktura e gjykatës, punën që bëjnë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura. Ndër të tjera u diskutua për të rejtat që ka sjell reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkt me Kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bëjnë secila zyre, me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës.

Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët, Universitetet me Shkollat e qytetit dhe të rajonit.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit me degët në Suharekë dhe Dragash për vitin 2018, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2018, të ardhura, lëndët në proces, lëndë që janë përfunduar në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, dhe ato të mbetura. Statistikat e punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 janë dëshmia numerike e përkushtimit maksimal për ti shërbyer qytetarëve.

Tabela e statistikave

Gjykata Themelore Prizren

Gjykata Themelore në Prizren	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2018	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2018	Gjithsej lëndët në punë deri në muajin dhjetor 2018	Lëndët e kryera gjatë vitit 2018	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2018	Përqindja e lendeve të zgjidhura gjatë vitit 2018
Dep. për Krime Të Rënda	Penale	113	128	241	134	107	104,69
	Paraprake	199	118	317	102	215	86,44
Dep. i Përgjithshëm	Penale	3632	2098	5730	2778	2952	132,41
	Paraprake	1125	601	1726	152	1574	25,29
	Civile	1346	2064	3410	1245	2165	60,32
	E.Civile	6189	1912	8101	2010	6091	105,13
	E.P. me Burg	31	141	172	146	26	103,55
	E.P. me Gjobë	612	662	1274	689	585	104,08
	Të Ndryshme	0	16452	16452	16452	0	100,00
	Trashëgimore	26	83	109	80	29	96,39
Jashtkontestimore	540	555	1095	544	551	98,02	
Dep. për të Mitur	Penale Para Kolegjit	216	166	382	132	250	79,52
	Përgatitore	88	202	290	186	104	92,08
Divizioni i Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3480	2239	5719	5039	680	92,08
TOTALI		17597	27421	45018	29689	15329	108,27



Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim te vitit 2018	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2018	Gjithsej lëndët në punë deri ne muajin dhjetor 2018	Lëndët e kryera gjatë vitit 2018	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2018	Përqindja e lendeve te zgjidhura gjatë vitit 2018
Dep. për Krime të Rënda	Penale						#DIV/0!
	Paraprake						#DIV/0!
Dep. i Përgjithshëm	Penale	315	179	494	254	240	141,90
	Paraprake	9	31	40	36	4	116,13
	Civile	278	126	404	97	307	76,98
	E. Civile	452	92	544	87	457	94,57
	E.P. me Burg	2	3	5	0	5	-
	E.P. me Gjobë	81	32	113	51	62	159,38
	Të Ndryshme	0	2689	2689	2689	0	100,00
	Trashëgimore	29	8	37	7	30	87,50
Jashtkontestimore	58	138	196	107	89	77,54	
Dep. për Të Mitur	Penale Para Kolegjit						#DIV/0!
	Përgatitore						#DIV/0!
Divizioni i Kundërvajtjes	Kundërvajtje	165	298	463	233	230	78,19
TOTALI		1389	3596	4985	3561	1424	99,03

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim te vitit 2018	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2018	Gjithsej lëndët në punë deri ne muajin dhjetor 2018	Lëndët e kryera gjatë vitit 2018	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2018	Përqindja e lendeve te zgjidhura gjatë vitit 2018
Dep. për Krime Të Rënda	Penale						#DIV/0!
	Paraprake						#DIV/0!
Dep. i Përgjithshëm	Penale	1502	585	2087	816	1271	139,49
	Paraprake	109	105	214	132	82	125,71
	Civile	828	706	1534	551	983	78,05
	E. Civile	1713	491	2204	335	1869	68,23
	E.P. me Burg	114	13	127	78	49	600,00
	E.P. me Gjobë	253	219	472	237	235	108,22
	Të Ndryshme	0	1985	1985	1985	0	100,00
	Trashëgimore	54	15	69	14	55	93,33
Jashtkontestimore	109	127	236	115	121	90,55	
Dep. për Të Mitur	Penale Para Kolegjit						#DIV/0!
	Përgatitore						#DIV/0!
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3189	944	4133	2043	2090	216,42
TOTALI		7871	5190	13061	6306	6755	121,50

Rastet e dhunës në familje të paraqitura në mënyrë tabelore



GJYKATA NË MEDIA

Ka një gjykatë më të lartë se ajo e drejtësisë, është gjykata e ndërgjegjes. Ajo zëvendëson të gjitha gjykatat tjera!

Gjykata ka reflektuar në mënyrë pozitive duke qenë bashkëpunuese dhe ka një nivel të mirë të transparencës. Gjatë vitit 2018 – Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar 160 komunikata të cilat kanë pasur për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe shqiptimin e dënimeve në rastet gjyqësore, njoftime për vizitat në gjykatë, takimet e punës dhe tryezat, si dhe ka publikuar mbi 1623 aktgjykime të plotfuqishme.



Si gjykata e vetme në Kosovë, Zyra për Informim me mjaft sukses po e publikon numrin e trembëdhjetë (13) të Buletinit Informativ “Gjykatë e Hapur”, e cila është një dritare e transparencës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Jemi tejet të motivuar që këtë mjet të transparencës po vazhdojmë ta mbajmë gjallë.

Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha mediat lokale, si dhe ato qendrore të cilat kanë transmetuar në mjetet e tyre të informimit në nivel shumë të kënaqshëm ngjarjet dhe materialet e shpërndara nga Gjykata. Ju falënderojmë për kontributin e juaj për një gjykatë të hapur dhe transparente.

INTERVISTË E SHKURTËR

Gjykata Themelore e Prizrenit, po arrin të zvogëloj dukshëm numrin e madh të lëndëve, në krahasim me numrin e vogël të gjyqtarëve që punojnë në divizionin penal. Me një përkushtim të tillë, punon edhe Luan Berisha gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, të cilin e ftuam për intervistën e shkurtër të këtij numri.



Luan Berisha

(gjyqtar në Departamentin e
Përgjithshëm – Penal)

1. Si udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni penal, cilat janë sfidat me të cilat përballeni me punën tuaj si gjyqtar?

Po sfidat me të cilat përballemi me punën tonë si gjyqtar janë të shumta, përkundër angazhimit maksimal profesional të punës për shkak të numrit të madh të lëndëve në krahasim me numrin e gjyqtarëve që punojnë në divizionin penal të departamentit të përgjithshëm mundohemi dhe kemi arritur që të zvogëlojmë numrin e lëndëve ashtu që për të arritur në një nivel ku lënda nga momenti i arritjes në gjykatë e deri në përfundimin e saj të jetë një periudhë e arsyeshme e nga ky vit kalendarik na janë shtuar edhe dy gjyqtar në këtë divizion por duhet theksuar se edhe një gjyqtar nga divizioni penal është pranuar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, por edhe përkundër kësaj unë si gjyqtar dhe kolegët e mi pos këtij disproporcioni nga numri i lëndëve me numrin e gjyqtarëve në secilin fund vit me rastin e rezultateve vjetore kemi arritur që për çdo vit në mënyrë permanente të zvogëlojmë numrin e lëndëve në krahasim me vitin paraprak e kjo fal angazhimit, punës profesionale dhe përkushtimit në punë.

Sfidë tjetër për mua si gjyqtar me të cilën përballemi gjatë punës sonë është nevoja e domosdoshme për rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve profesional të cilat pa dyshim me punën dhe kontributin e tyre do të na ndihmonin që sa më shpejt të arrihet një proporcion dhe nivelizim në raport me numrin e lëndëve, numrin e gjyqtarëve.

Një sfidë tjetër që mjaft shumë po shkakton pengesa në përfundimet e lëndëve është edhe çështja e ndryshimit të vendbanimeve dhe vendqëndrimeve të palëve në procedurë, andaj duhet të kërkojmë edhe asistimin e organeve kompetente për sigurimin e adresave të vendbanimeve dhe

vendqëndrimeve të njëjtëve e të cilat sigurime kërkojnë kohë dhe periudhë të gjatë e kjo është një ndër sfidat me të cilat po përballemi gjatë punës sonë profesionale.

2. Sa është transparente gjykata përball publikut në punën e saj? A mendoni se qytetarët dinë mjaftueshëm për gjyqësorin?

Gjykata është transparente në nivel të lartë përball publikut në punën e saj, këtë konstatim e mbështes në bazë të fakteve se pranë gjykatës sonë zyrtarja për informim është përherë transparente lidhur me çdo veprim të gjykatës, informon rregullisht publikun për të gjitha shqyrtimet që zhvillohen pranë kësaj gjykate që nga fillimi i çështjes dhe në të gjitha fazat e saj e deri në përfundim të shqyrtimit.

Shqyrtimet gjyqësore përherë janë publike ku prezenca e të gjithë qytetarëve është e lirë, me përjashtim të shqyrtimeve kur me kërkesë të palës apo sipas detyrës zyrtare gjykata merr vendim që publiku të përjashtohet nga shqyrtimi dhe i njëjti të jetë i mbyllur, por këto raste janë atëherë dhe vetëm atëherë kur plotësohen kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Në kuadër të transparencës të gjykatës përball publikut duhet shtuar edhe faktin se të gjitha aktgjykimet e kësaj gjykate janë publike dhe për të njëjtat publiku mund të ketë qasje nëpërmjet faqes zyrtare elektronike të gjykatës.

Sa i përket dijenisë të qytetarit për gjyqësorin konsideroj se çdo kush që është i interesuar për punën e gjykatës ka mënyra të ndryshme për të pasur dijeni për punën e gjyqësorit, qoftë me prezencë në shqyrtime, përcjelljen e shqyrtimeve drejtpërdrejt apo përcjelljen e shqyrtimeve nëpërmjet mjeteve të shkruara dhe atyre elektronike. Sipas bindjes sime qytetarët kanë dijeni të mjaftueshme për punën e gjyqësori, pikërisht nga faktet dhe rrethanat e lartcekura e kjo në rend të parë duke ju falënderuar transparencës të gjyqësorit.

3. Gjatë punës suaj të përditshme, cilët janë lëndët më problematike dhe si i tejkaloni vështirësitë në zgjidhjen e tyre?

Gjatë punës sime të përditshme si gjyqtar lëndë problematike sipas mendimit tim nuk ka, nëse ekziston dallimi i lëndëve sipas mendimit tim duhet bërë dallimin e lëndëve për nga natyra e veprës penale, pesha e saj dhe kuptohet pasoja e shkaktuar.

Në punën time të përditshme, shumicën më të madhe të punës dhe kohës si anëtar i kolegjeve penale pranë Departamentit të Krimeve të rënda vërehet që sa i përket dallimeve të lëndëve sipas natyrës të veprës penale, peshës të saj dhe kuptohet pasojës të shkaktuar në këtë departament komforë dispozitave ligjore dhe kompetencës në bazë të Kodit të Procedurës Penale shqyrtohen lëndë dhe

çështje më të ndjeshme që për nga natyra e veprës penale janë më të ndjeshme, pesha e këtyre veprave penale është më e rëndë e nga kjo rrjedhë që edhe pasoja e shkaktuar është më e lartë,

Vështirësitë në këto lëndë tejkalohen me qasje profesionale, punë të përkushtuar, si dhe respektimin e dispozitave ligjore si dhe parimeve bazë për një gjykim të drejtë, të shpejtë dhe efikas e kjo falë profesionalizmit, njohurive profesionale si dhe praktikës gjyqësorë të deritashme, andaj kur posedohen predispozitat e cekura më lartë atëherë edhe vështirësitë eventuale në zgjedhjen e lëndëve tejkalohen në mënyrë më të qetë dhe më të shpejt.

4. Statistikat e fundit tregojnë për rritjen e numrit të lëndëve nga dhuna në familje, pse mendoni se është kjo rritje dhe a kanë prioritet këto lëndë në zgjedhjen e tyre?

Lëndët ku objekt i shqyrtimit është dhuna në familje janë lëndë të natyrës mjaft mos të themi shumë të ndjeshme, duke pas parasysh që familja është bazament dhe prioritet për çdo shoqëri. Pranë gjykatës sonë është vërejtur një rritje e ndjeshme e lëndëve të kësaj natyre, arsyet se pse ka ardhur deri te kjo rritje janë të natyrës dhe shkaqeve të ndryshme, arsyet se pse vjen deri te dhuna në familje duhet kërkuar te vetëdijesimi i vet qytetarit dhe të kërkojnë të gjenden arsyet bazë se pse i njëjti aplikon dhunë në atë më të çmuarën – familjen, ne mund vetëm të pre supozojmë shkaqet dhe arsyet për rritje të lëndëve të kësaj natyre por në mënyrë më profesionale dhe më të përgjithësuar duhet të angazhohen të gjitha institucionet e shoqërisë, organizatat e ndryshme, të organizohen simpoziume, seminare, trajnime apo në ndonjë mënyrë tjetër çfarëdo qoftë ajo të ju shpjegohet qytetarëve rëndësia dhe roli pozitiv dhe primar i familjes, rëndësia dhe autoriteti i saj në shoqëri dhe për të ardhmen e saj si dhe pasojat eventuale të cilat dhuna si dhunë në familje dhe fenomen lë në familje në veçanti dhe në shoqërinë tonë në përgjithësi. Angazhimi i lartcekur në këtë drejtim duhet të jetë sa më i shpejt dhe është çështje imediate para se ajo të marrë përmasa më të mëdha dhe më drastike dhe ndoshta atëherë edhe pasojat dhe të gjitha ato që rrjedhin nga ajo janë të pamundshme të sanohen.

Këto lëndë pa dyshim se kanë prioritet në zgjedhjen e tyre për arsye të specifikave dhe arsyeve të lartcekura.

5. Gjatë punës suaj si gjyqtar, cilat janë parimet të cilat i merrni për bazë me rastin e zgjidhjes së një çështje?

Parimet bazë me rastin e zgjedhjes së një çështje të cilat i marrë për bazë janë parimet e Kodit të Procedurës Penale, si dhe dispozitat ligjore të saj si dhe të Kodit Penal, respektimi i të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Konventave Ndërkombëtare si dhe respektimi i barazisë të palëve dhe mos diskriminimi i tyre nga asnjë aspekt e të gjitha këto në drejtim të asaj për një shqyrtim të drejt, të shpejt dhe efikas.

SI T'I QASEMI GJYKATES?

Njoftim!

Gjykata Themelore në Prizren dhe degët e saj, sipas kërkesës së personit, e në raste të caktuara edhe sipas kërkesës së institucioneve kompetente, lëshojnë **certifikatë nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë.**

Kërkesa – aplikacioni për certifikatë dorëzohet në shërbimin e pranimit të Gjykatës çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në orën 12:00 dhe nga ora 13:00 deri në orën 15:30.

Aplikacioni në formën fizike merret në sportelin e shërbimit të pranimit dhe plotësohet nga aplikanti – kërkuesi i certifikatës ose personi i autorizuar. Personi i autorizuar konsiderohet vetëm ai person që posedon autorizim të noterizuar.

Në rastin e aplikimit, duhet të bashkëngjitet kopja e letërnjoftimit/pasaportës valide.

Lidhur me certifikatat që përdoren për çështje të punësimit nuk paguhet taksa, ndërsa në raste tjera taksa paguhet sipas Udhëzimit Administrativ për çka secili person informohet në sportel me rastin e aplikimit.

Certifikatat zakonisht tërhiqen pas një dite nga dita e dorëzimit të kërkesës dhe atë prej orës 14:00 deri në ora 15:00, përjashtim mund të kenë vetëm rastet urgjente dhe kryesisht për shkaqe humanitare.

Po ashtu Gjykata Themelore e Prizrenit kryen edhe këto shërbime:

- Vula apostile
- Ndërmjetësimi
- Përmbartimi i vendimeve gjyqësore
- Kopjim i dokumenteve zyrtare

A e dini se...?!

(Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje)

Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;

1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;

1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;

1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;

1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;

1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër;

1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;

1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;

1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.

GJYKATA THEMELORE- PRIZREN
OSNOVNI SUD PRIZREN
HPN.nr. /2019

GJYKATA THEMELORE- PRIZREN
OSNOVNI SUD PRIZREN

Ja lutem që sipas evidencës me të cilën dispononi të më jepni certifikatë në ndaj meje nëqë procedurës nuk është ngjitur aktakuzë, si mëkam dituar në mbledhjet e përfundimtare për vepra penale nga kompetenca e gjykatës Themelore në Prizren për të cilën mund të shpikohet dënimi me burg.

Molim vas da po evidenciji sa kojim raspolozite, da mi se da izvod da se protiv mene ne vodi postupak, da nije podignuta optična miš da sam pravočasno obavijestio za krivično delo koje su u nadležnosti Osnovnog suda u Prizrenu, za koja dela može da se izrekne kazna zatvora.

Për vete jap këto shënime:
Uvenci ovog dajem sledeće podatke:

Emri _____
Ime _____
Mbiemri _____
Prezime _____
Mbiemri i vajzës/igjina femërore/ _____
Drejtpisja prezime/cemski pol _____
Data e Lindjes _____
Rudjen dana _____
Vendi i Lindjes _____
Mesto rođenja _____
Emri i Babës _____
Ime Oca _____
Emri i Nënë _____
Ime majke _____
Nr.personal _____
Izaci broj _____
Me banim të përhershëm në _____
Sa stambin boravkom u _____
Rruga dhe numri _____
Ulica i broj _____
Certifikata në nevojitet për _____
Uverenje mi treba za _____

Nitack/imi potpis _____



Kontaktioni Gjykatën Themelore të Prizrenit

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122



Adresa:
**Gjykata Themelore
e Prizrenit**

Rr. "Ibrahim Lutfiu",
p.n. Prizren, Kosovë

GJYKATË E HAPUR
Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
Janar 2019

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 13, janar 2019
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org

Vizito:
www.gjyqesori-rks.org

